

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: Materiale pastrimi dhe dezinfektimi

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Detergjentë-
39831200-8**

**VLERA E FONDIT LIMIT:3,750,000 (tre milion e shtatëqind e pesëdhjetë mijë) Lek, pa
TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes (Njësia e Prokurimit)** , ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 4;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 9

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Fusha e veprimtarisë së operatorit ekonomik ofertues duhet të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar **duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlogaritur e fondit limit që konkurron.** *Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros jo më të vogël se vlera e përlogaritur e fondit limit që konkurojnë, në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar është në përpjestim të drejtë me fondin limit të procedurës. Kërkesat e mësipërme i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjëndjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

Shënim: *Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike".*

2.2.2. Operatori ekonomik ofertues duhet të mos ketë detyrime për taksat vendore për Vitin 2026 sipas Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar), duke paraqitur një vërtetim nga organet e qeverisjes vendore ku ushtron aktivitetin. Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, vërtetimin nga organet e qeverisjes vendore duhet ta ketë secili subjekt më vete. *(Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me plotësimin e Shtojcës 9. Operatori*

ekonomik i renditur i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara shpalljes fitues, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimin e shlyerjes së taksave vendore).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, në nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, në ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2025 sipas kësteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së përlllogaritur të fondit limit që prokurohet.** Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

2. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar **me ente publike**, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
3. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar **me subjekte private**, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 55, pika 4/b VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” në kushtet kur kjo procedurë prokurimi klasifikohet procedurë e hapur e thjeshtuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit,

që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Në zbatim të nenit 55, pika 4/b në kushtet kur kjo procedurë prokurimi është procedurë e thjeshtuar të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 20 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Operatori ekonomik ofertues, në rast se nuk është prodhues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose autorizim distributor të autorizuar ku të vertetohet lidhja me prodhuesin, për mallrat objekt prokurimi, i cili duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit, si telefon, fax, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 40, pika 5, gërma a) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i cili përcakton se: ”Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për prodhimin dhe/ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

2.4.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë ditën dhe orën e hapjes së ofertave mostra për artikujt sipas tabelës së mëposhtme. Mostrat duhet të jenë në amballazhet origjinale dhe në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të kërkuara dhe të paraqitura në ofertën teknike. Mosparaqitja e mostrave, dorazi , si dhe nëse ka mungesa mostrash, për artikujt e kërkuar në ditën e hapjes së ofertave është kusht skualifikues.

<i>Nr</i>	<i>Emertimi i mallit</i>	<i>Njësia</i>	<i>Sasia</i>
<i>1.</i>	<i>Solucion per duart</i>	<i>copë</i>	<i>1500</i>
<i>2.</i>	<i>Solucion per enet (guzhine)</i>	<i>litra</i>	<i>1500</i>
<i>3.</i>	<i>Solucion per pllakat</i>	<i>litra</i>	<i>3000</i>
<i>4.</i>	<i>Dezinfektant per banjo(Klor Leng)</i>	<i>litra</i>	<i>3000</i>
<i>5.</i>	<i>Shtupa pastrimi</i>	<i>copë</i>	<i>2000</i>
<i>6.</i>	<i>Shkopinj per shtupat</i>	<i>copë</i>	<i>1000</i>
<i>7.</i>	<i>Pastrues WC (leng)</i>	<i>litra</i>	<i>3000</i>
<i>8.</i>	<i>Pluhur larës dore</i>	<i>kg</i>	<i>1600</i>
<i>9.</i>	<i>Pluhur larës lavatriçe</i>	<i>kg</i>	<i>1500</i>
<i>10.</i>	<i>Zbardhues rrobash</i>	<i>litra</i>	<i>800</i>
<i>11.</i>	<i>Kartopiceta duarsh</i>	<i>pako</i>	<i>4000</i>
<i>12.</i>	<i>Leter Higjenike për WC-në</i>	<i>copë</i>	<i>4000</i>

- Mostrat e kërkuara duhet të kenë një etiketë të ngjitur, e cila do të përmbajë: mostër “emri i artikullit”, numrin rendor sipas ofertës së paraqitur, objektin dhe datën e zhvillimit të tenderit, emrin e ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e operatorit ekonomik ofertues.
 - Mostrat duhet të jenë në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të kërkuara.
- Operatori ekonomik duhet të deklarojë se mallrat që do të dorëzoje do të jenë të njëjtë me mostrat e paraqitura ditën e zhvillimit të procedurës së prokurimit.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të cilës merr përsipër të kryerje shërbimin e transportit të të gjithë artikujve të kërkuar në adresën e autoritetit kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77 të ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6, gërma a) të VKM Nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të

mallrave. Kriteri i vendosur për paraqitjen e mostrave është kërkuar për të vërtetuar lidhjen midis OE konkurrues në raport me mostrën e paraqitur ditën e hapjes së tenderit dhe dokumentacionit shoqërues të paraqitur në SPE për përmbushjen e kriterëve të kualifikimit. Gjithashtu për të vërtetuar plotësimin e kërkesave të përcaktuara në specifikimet teknike ku mostra e kërkuar do të shfaqë cilësinë e produktit final i cili do të lëvrohet nga OE fitues gjatë gjithë zbatimit e kontrates.

2.4.3 Operatori ekonomik të vërtetojë (me deklaratë) që artikujt (solucionet) objekt prokurimi, të kenë afat përdorimi të paktën 1 vit nga moment i lidhjes së kontrates.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77 të ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6, gërma a) të VKM Nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar dhe do të ofrojë produktet e kerkuara me cilesi, pasi keto produkte do të perdoren për nevojat e institucionit ,çerdheve, kopshteve, konviktit dhe shkollave brenda vitit dhe prandaj eshte e domosdoshme qe produktet te jene cilesore dhe konkretisht me afat perdorimi 1 vit.

2.4.4 Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë çertifikate të menaxhimit të cilësisë ISO 9001-2015 ose ekuivalente (ose version të përditësuar) që i referohet objektit të prokurimit, nga Prodhuesi, ose nga distributori i autorizuar. (Çertifikata duhet të jetë e lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të cilat janë të akredituara nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (DPA), ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Ky kriter u vendos në përputhje me parashikimin e nenit 36 dhe nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 44, të VKM-seNr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ne baze te Njoftimit të Agjencisë së Prokurimit Publik Nr.2502 Prot., date 09.04.2021, si dhe ligjit nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, ku percaktohet se kjo Çertifikate duhet të jetë lëshuar nga organizma certifikues të akredituar, me qëllim që enti prokurues të krijojë sigurinë që operatorët ekonomik ofertues i kanë kapacitetet teknike lidhur aftësinë e tyre për të kryer shërbimin objekt kontrate. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente. Kjo kërkesë vjen nisur dhe nga fakti që produktet e prokuruar do të përdoren dhe në ambjentet e çerdheve dhe kopshteve të cilat janë ambjente rezident për fëmijë të grupmoshës 1-6 vjeç.

II. ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet teknike janë hartuar nga njësia e prokurimit sipas kontratave të ngjashme në përputhje me nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenit 40,

pika 2, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe refeuar, *Katalogut të OBP "Blerje materiale të ndryshme për pastrim", i përditësuar date 17.06.2025.*

Parametrat e përcaktuar në treguesit respektivë janë vendosur në raport me kërkesat e AK për sigurimin e artikujve cilësorë si në këndvështrimin fiziko-kimik por edhe në këndvështrimin sasior që ka të bëjë me volumin, peshën specifike apo përmasat e tyre.

Përshkrimi i produkteve të kërkuara është bërë në mënyrë të detajuar duke përcaktuar në mënyrë të qartë produktin e kërkuar nga ana cilësore dhe sasiore, duke mos krijuar konfuzion mbi produktet e kërkuara.

Në lidhje me treguesit e përcaktuar në specifikimet e kërkuar për secilin produkt, kryesisht ato solucione, është e nevojshme të sqarojme se:

- Matja e densitetit është një parametër i rëndësishëm i cilësisë për produktet e pa përpunuara dhe të përfunduara në forma të ngurta dhe të lëngëta dhe kryhet me teknika të ndryshme. Matja e dendësisë, e cila është veçanërisht e rëndësishme në përcaktimin e pastërtisë së materialeve para përpunimit, është e rëndësishme për të përcaktuar nëse një material i huaj është i përzier me lëndën e parë. Nga ana tjetër ky tregues është në funksion të përcaktimit homogjenitetit të produktit.
- Treguesi i Ph (përmbajtja e joneve H⁺) tek solucionet e lëngshme dhe sapunët është shumë e rëndësishme për të përcaktuar neutralitetin (as acid dhe as bazik), sepse në të dy rastet ndikon negativisht në shëndetin e fëmijëve. Ndërsa në rastin e detergjentit pluhur, dhe solucioneve për pastrimin e sobave, zbardhues dezinfektues rrobash, kërkohet me Ph më të lartë duke kaluar në bazë për arsye të ndikimit në emulsionet shkumuese.
- Tretshmëria e substancave në ujë është një nga kushtet kryesore që ndikon në formimin e përbërjes. Sa më e lartë të jetë tretshmëria, aq më të pastra janë produktet.
- Treguesi i lagështirës është shumë i rëndësishëm pasi lagështia ndikon negativisht në jetëgjatësinë e produktit (shpërbën substancat).
- Substancat teknsioaktive-substancat organike ose përzierjet që janë lëndë përbërese të detergjentëve, që veprojnë në sipërfaqe dhe përbëhen nga një ose më shumë grupe hidrophile dhe hidrofobe dhe që kanë aftësinë të zvogëlojnë tensionin sipërfaqësor të ujit dhe të formojnë shtresa shpërndarëse ose thithëse monomolekulare në sipërfaqen e kontaktit ujë-ajër duke formuar emulsion ose mikroemulsion ose micela që thithen në kontakt me ujin dhe sipërfaqet e ngurta.
- Referuar përcaktimeve si “me aromë të mirë, të lehtë” në disa produkte objekt prokurimi sqarojme se, duke qënë se këto produkte janë parashikuar të përdoren në ambiente rezidenciale të frekuentuara nga fëmijë të moshave 1- 6 vjeç (çerdhe dhe kopshte) këshillohet që aromat e tyre të jenë sa më të lehta dhe të këndshme me ndjeshmëri sa më të ulët në shqisën e të nuhaturit të fëmijëve. Gjithashtu sqarojmë se AK, në zbatim të parimeve të përcaktuara në LPP, me qëllim që mos të shammgë apo ngushtojë konkurrencën në këtë procedurë prokurimi, nuk ka përcaktuar aroma specifike (aroma konkrete si psh lulesh, frutash, bimësh etj), por ka konsideruar që përcaktimi “e mirë” dhe “e lehtë” është gjithpërfshirës.

Argumentim mbi hartimin e Fondit Limit:

Për përcaktimin e fondit limit, AK është bazuar në kriteret e mëposhtme:

- Buxhetin e vitit 2026 bazuar në VKB-në nr.139 datë 26.12.2025 “Mbi miratimin e buxhetit vjetor të vitit 2026 dhe PBA 2026-2028 të Bashkisë Korçë”.

- Në çmimet e kontratës së mëparshme, të vitit 2025, të Faturës nr.76/2025 datë 04.08.2025 me FH nr.41 date 04.08.2025.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

NJESIA E PROKURIMIT

KRISTINA ZAÇELLARI

SONJELA ZGURI

MARSELA TËROVA